



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga "Abdi Toptani", ish- hotel "Drin", Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 1754/5 Prot.

Tiranë, më 10.11.2017

V E N D I M

Nr. 230, datë 10.11.2017

"Për zgjatjen e afatit për zbatimin e Vendimit Nr. 219, datë 31.10.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit që përmban shkresa e protokolluar pranë KMSHC me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, nga punonjësi **", në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar", në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 219, datë 31.10.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit që përmban shkresa e protokolluar pranë KMSHC me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, nga punonjësi *****", në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar", në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Me Urdhrin e verifikimit nr. 1563/1 Prot., datë 12.09.2017, "Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa e punonjësit *****", protokolluar me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, në lidhje me moslejimin për kryerjen e funksioneve sipas pozicionit të punës ku është emëruar, si dhe me ndërprerjen e pagës që nga muaji Qershor 2017", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesin e verifikimit të këtij rasti, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë, proces i cili është përmblyllur me Vendimin Nr. 219, datë 31.10.2017, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. *Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të marrin masat për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë në lidhje me administrimin e shërbimit civil, duke vepruar si më poshtë:*
 - ✓ *Të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 40, datë 01.09.2014, të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin e punës, “Inspektor në Sektorin e Inspektimeve të Tjera Shëndetësore”.*
 - ✓ *Të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 222, datë 17.3.2015, të Kryeinspektorit, për emërimin e përkohshëm të punonjësit ***** në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë.*
 - ✓ *Të nxjerrin aktin për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me institucionin për punonjësën në fjalë të emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.*
2. *Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.*

Me marrjen dijani të këtij vendimi, me shkresën nr. 915/21 prot., datë 03.11.2017, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ka informuar Komisionerin se, për shkak të ngarkesës së punës që përballon ky institucion, pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar” është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe kryerjen e detyrave funksionale që i ka ngarkuar ligji. Për më tepër, nisur nga fakti që Inspektoratet në shkallë vendi janë duke kaluar në proces ristrukturimi, në kuadër të riformatimit dhe ristrukturimit të ministrive dhe institucioneve të varësisë, nuk është ende e qartë nëse ky pozicion do të vazhdojë të ekzistojë. Për këtë arsye, ISHSH, Qarku Tiranë dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, të ngarkuar me zbatimin e detyrave të përcaktuara në Vendimin Nr. 219, datë 31.10.2017, e kanë objektivisht të pamundur marrjen e masave për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në përputhje me rekomandimet e Komisionerit, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këto rrethana, vlerësoj se afati për kryerjen e detyrave të përcaktuara në dispozitivin e Vendimit Nr. 219, datë 31.10.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit që përmban shkresa e protokolluar pranë KMSHC me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, nga punonjësi ***** në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë”, duhet të shtyhet deri në përfundim të procesit të ristrukturimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Zgjatjen e afatit për kryerjen e detyrave të përcaktuara në dispozitivin e Vendimit Nr. 219, datë 31.10.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit që përmban shkresa e protokolluar pranë KMSHC me nr. 1563 prot., datë 28.8.2017, nga punonjësi *****; në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Sanitar”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, Qarku Tiranë”, deri në përfundim të procesit të ristrukturimit.*
- 2.** Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, menjëherë pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, të njoftojë me shkrim Komisionerin për mënyrën e zbatimit të Vendimit Nr. 219, datë 31.10.2017, duke bashkëngjitur edhe aktet që materializojnë zbatimin e tij.
- 3.** Të njoftohen për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA